

### **1. A pati një trend rritës për kërkesa pune në pranverë? Nëse po, sa %?**

Gjatë periudhës Janar- Gusht 2022 në Zyrat e Punësimit u shpallën 24,966 vende të lira pune (VLP) ose 82% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

### **2. Cilat ishin profesionet më të kërkuara?**

Profesionet më të kërkuara në këto VLP janë: rrobaqepës, këpucar, punonjës në industri të tjera përpunuese, operator në shërbimin Call Center, punonjës në fushën e ndërtimit, kamarier, banakier, sanitar, agjent shitjesh, dhe specialist me arsim të lartë me profil ekonomik, juridik dhe mjekësor.

### **3. A ishte pasiguria ekonomike nga lufta një ndër shkaqet që coi në rritjen e këtyre kërkesave?**

Rritja e numrit të VLP-ve të shpallura gjatë 6 mujorit 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë u ndikua nga faktori i sezonalitetit, zhvillimi i panairëve të punës dhe nisja e programve të nxitjes së punësimit.

### **4. Për çfarë kategorie profesionesh kishin më shumë nevojë bizneset?**

Numri më i lartë i VLP-ve të shpallura rezulton të jetë në kategoritë:

- Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve
- Zejtarë zanatçinjtë dhe profesione të lidhura me to
- Punonjës në industri
- Profesione elementare